



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 11.02.2021

N J O F T I M

Mbështetur në Vendimin e Rektorit të datës 11.02.2021 “Mbi rishpalljen e konkursit për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2020 – 2021, në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit”, njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar që duan të aplikojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagog të jashtëm), se duke filluar nga data **11.02.2021 deri më 17.02.2021**, duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, dokumentacionin përkatës sipas specialitetit ku aplikon.

I. DEPARTAMENTI I DISIPLINAVE BIOMJEKËSORE DHE HUMANE

- **Shkenca Humane dhe Sociale** (Mod. Bioetikë) “**Bachelor**” 1(një) Lektor, As/Lektor

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për Lektor, As/Lektor në lëndën: “**Shkenca Humane dhe Sociale** (Moduli: Bioetikë), në Departamentin e Disiplinave Biomjekësore dhe Humane janë si më poshtë:

- Curriculum Vitae (C-V, Formati Europass)
- Diplomë dhe Certifikatë e Notave të studimeve “Bachelor” (fotokopje të noterizuara) (Mesatarja e notave duhet të jetë mbi 8).
- Diplomë dhe Certifikatë e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND me mesatare notash mbi 8 (fotokopje e noterizuar).
- Diplomë të Gradës Shkencore ose titullit akademik, Prof., Prof.Asc., Dr, nëse ka (fotokopje e noterizuar)
- Fusha e studimit dhe diplomimit duhet të jetë e njëjtë me fushën e kërkuar.
- Preferohen kandidatët që kanë përvojë mësimdhënieje në IAL.
- Dëshmi penaliteti (me vetë-deklarim në e-albania) (e detyrueshme).
- Fotokopje të kartës së identitetit.

II. Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm nëpërmjet postës, duke shenuar qarte mbi zarf, pozicionin për të cilin konkurojnë, departamentin, fakultetin, lëndën ku aplikojnë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- ✓ Curriculum Vitae (e detyrueshme)

- ✓ Diplomë dhe Certifikatë e notave të studimeve Bachelor (fotokopje e noterizuar) (e detyrueshme)
- ✓ Diplomë dhe Certifikatë e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND (fotokopje e noterizuar) (e detyrueshme)
- ✓ Certifikatën e gradës “Doktor i Shkencave” (nqse ka) (fotokopje)
- ✓ Dëshminë e titullit “Profesor i Asociuar” (nqse ka) (fotokopje)
- ✓ Dëshminë e titullit “Profesor” (nqse ka) (fotokopje)
- ✓ Fotokopje e kartës së identitetit (fotokopje) (e detyrueshme)
- ✓ Dëshmi penaliteti (vetëdeklarim) (e detyrueshme)
- ✓ Numrin e llogarisë bankare (nqse ka) (fotokopje)
- ✓ Vërtetim nga qendra e punës me lejen për t’u angazhuar si staf akademik me kohë të pjesshme pranë FSHR – UST (nqse është i punësuar)
- ✓ Vërtetim nga Dega e Tatim Taksave në rast se është i/e papunësuar .
- ✓ Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

III. Vetem paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.

IV. Në zarf duhet të shënohet adresa e sakte e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti, Departamenti, **specialiteti ku aplikon**, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail e konkurentit.

V. Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

REKTOR

Prof. Dr. Agron KASA